



Derivatet e duhura për makinën tuaj, me cilësi të garantuar!

Italian Petrol është brend evropian në Kosovë, me cilësinë më të lartë të garantuar të derivateve në treg.

BONUS KARTELA E LOJALITETIT “CARTAMAXIMA”

Kjo kartelë përdoret për blerje të derivateve dhe mallrave të konsumit të gjerë në tërë rrjetin e Italian Petrol në Kosovë.

Për çdo euro të shpenzuar në derivate apo në blerje të mallrave të përgjithshme përmes kartelës së lojalitetit CARTAMAXIMA me para të gatshme, Italian Petrol Kosova ju dhuron deri në 2.5 euro cent, që mund të shfrytëzohen në çdo kohë për blerje të karburanteve. Me kartelen e lojalitetit klientët do të përfitojnë edhe nga lojrat shpërblyese dhe promocionet që do të jenë në rrjetin e IP-KOS.

Kartelat e lojalitetit i përmbajnë standardet më të larta evropiane të sigurisë, me sigurinë e njëjtë të sistemit bankar.

Kartelat janë me çip, shirit magnetik dhe kod unik (PIN), si dhe me rreze (contactless). Klientët mund ti qasen llogarisë së kartelës së tyre online, për ti parë shpenzimet si dhe pikët e grumbulluara nga çdo blerje në Italian Petrol. Me kartelë të lojalitetit, klientët mund të kontrollojnë shpenzimet për derivate dhe të menaxhojnë llogarinë e tyre.

Klientët mund në çdo kohë ti shfrytëzojnë pikët e grumbulluara në tërë rrjetin e Italian Petrol Kosova.

Në çdo pikë të shitjes së IP, mund të aplikohet për kartelën e lojalitetit, e cila është një dhuratë nga Italian Petrol Kosova për klientët e vet.

Vërejte: *Grumbullimi i pikëve bëhet vetëm për pagesat me para në dorë (cash).*



FORMULAR APLIKIMI

BONUS KARTELA E LOJALITETIT CARTAMAXIMA

JU LUTEMI KËTË FORMULAR APLIKIMI PLOTËSOJENI ME GËRMA TË MËDHA TË SHTYPIT

Numri i kartelës (vetëm për përdorim zyrtar):

Të dhënat personale (*obligative)

*Emri:

*Mbiemri:

*Data e lindjes:

Gjinia:

Profesioni:

*Telefoni (celular):

*E-mail adresa:

Adresa e banimit (Rr. nr.):

Qyteti dhe kodi postar i qytetit:

Të dhënat për automjetin (opsionale)

Marka e veturës (p.sh. audi):

Modeli (p.sh. A4):

Viti i prodhimit:

Lloji i karburantit:

NAFTË

BENZINË

GAZ

Nënshkrimi i aplikuesit

Emri dhe Mbiemri

Data

Nënshkrimi

X

Nënshkrimi i zyrtarit nga IP-KOS

Emri dhe Mbiemri

Data

Nënshkrimi

X

Politika për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale në kuadër të programit të bonus kartelës së lojalitetit: CARTAMAXIMA

Të dhënat personale:

Të gjitha informatat e marra nga klienti në kuadër të programit të bonus kartelës së lojalitetit Cartamaxima, duke përfshirë dhe të dhënat personale do të trajtohen në përputhje me rregullat e brendshme të IP-KOS sh.p.k., për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sipas Ligjit Nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke pranuar kushtet e përgjithshme të bonus kartelës së lojalitetit "Cartamaxima" mbajtësi i kartelës është pajtuar që: IP-KOS sh.p.k. të përdor të dhënat personale për marketing direkt me SMS dhe E-mail, ose me qëllim që të verifikoj të dhënat personale.

Duke pranuar këto rregulla mbajtësi i bonus kartelës së lojalitetit: Cartamaxima, pajtohet që të dhënat personale të regjistrohen, ruhen dhe përpunohen sipas Ligjit nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe akteve tjera nën ligjore si dhe rregullave të brendshme të IP-KOS sh.p.k.

Deklaratë: mbi miratimin për të ruajtur dhe përdorur të dhënat personale për qëllime të marketingut direkt.

Unë i/e poshtë-nënshkruari/a, me anë të kësaj deklaratë shpreh pëlqimin tim për ruajtjen, përpunimin si dhe përdorimin e të dhënave personale në përputhje me Ligjin nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale, për qëllim të anëtarësimit në programin e bonus kartelës së lojalitetit "Cartamaxima", si dhe marketingut direkt nga ana e kompanisë "IP-KOS sh.p.k." për qëllime të më poshtme:

1. *Anëtarësim në programin e kartelave të lojalitetit "Cartamaxima":

PO

JO

2. *Marketing dhe promociione në lidhje me produktet dhe shërbimet që ofron IP-KOS sh.p.k.:

PO

JO

Pëlqimet e shprehura më sipër përfshijnë informatat personale si: emrin, mbiemrin, datën e lindjes, gjininë, profesionin, e-mail adresen, adresen e vendbanimit, numrin e telefonit, te dhënat mbi automjetin.

Me anë të kësaj deklaratë, pranoj se jam njohur me të drejtat e mija për:

- Qasje dhe ndryshim të të dhënave personale;
- Kërkesë me shkrim duke arsyetuar bllokimin për përpunimin e të dhënave personale për arsye apo situata të veçanta;
- Kërkesë me shkrim duke arsyetuar bllokimin për përpunimin e të dhënave personale për qëllime marketingu;
- Ankesën në rastin e transferimit të të dhënave të mija personale në një tjetër kontrollues.

Unë rezervoj të drejtën për të hequr në çdo kohë të ketij aprovimi në lidhje me të dhënat personale, qoftë me shkrim apo në ndonjë formë tjetër.

Të gjitha të dhënat personale janë dhënë në mënyrë vullnetare, pa qenë nën lajthim, mashtrim, kanosje apo shtrëngim.

Nënshkrimi i aplikuesit

Emri dhe Mbiemri	Data	Nënshkrimi
		X

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË PËRDORIMIT TË BONUS KARTELËS SË LOJALITETIT “CARTAMAXIMA”

Grumbillimi i pikëve të bonusit

Në çdo blerje vetëm me para të gatshme të derivateve dhe mallrave të konsumit të gjerë në tërë rrjetin e Italian Petrol në Kosovë (IP-KOS sh.p.k.), duke përdorur bonus kartelën e lojalitetit CARTAMAXIMA (tutje: kartela), grumbullohen pikë bonusi. Pikët e bonusit përfitohen menjëherë pas çdo blerje, si dhe në varësi të shumës së shpenzuar, në fund të çdo muaji dhe në fund të çdo viti shpërblehen me pikë shtesë bonusi nga IP-KOS për besnikëri. Pas aktivizimit të kartelës, pikët e bonusit mund të shpenzohen menjëherë pas çdo blerje.

Metodologjia e grumbullimit të pikëve të bonusit:

Në çdo euro të shpenzuar bartësi i kartelës përfiton 1 pikë bonusi, apo 1.00% të 1 Euro, e cila është e barazvlefshme me 1 euro cent. Nëse bartësi i kartelës shpenzon brenda muajit 100 euro, atëherë ka grumbulluar 100 pikë bonusi të menjëhershme, dhe si shpërblim besnikërije IP-KOS e shpërblen edhe me 50 pikë bonusi shtesë në fund të muajit si dhe me 50 pikë bonusi shtesë në fund të vitit, që në total bartësi i kartelës për 100 euro të shpenzuara ka përfituar 200 pikë bonusi, të barazvlefshme me 2 euro. Andaj sa më e lartë që është shuma e shpenzuar aq më i madh është përfitimi nga pikët e bonusit dhe shpërblimi i besnikërisë.

Skema e përfitimeve në varësi të shpenzimeve me bonus kartelën e lojalitetit Cartamaxima

Shuma e frunizimit mujor		Bonusi i menjëhershëm %	Pikë bonusi shtesë në fund të muajit %	Bonusi total mujor %	Bonusi shtesë i lojalitetit vjetor	Totali i bonusit të akumuluar
Nga (EUR)	Deri (EUR)					
-	99	1.00%	0.00%	1.00%	0.50%	1.50%
100	199	1.00%	0.50%	1.50%	0.50%	2.00%
200	499	1.00%	0.80%	1.80%	0.50%	2.30%
mbi	500	1.00%	1.00%	2.00%	0.50%	2.50%

Niveli i përfitimit të pikëve të bonusit mujor dhe vjetor azhurnohet në mënyrë automatike në fillim të çdo muaji. Programi i bonus kartelës së lojalitetit “Cartamaxima” është i krijuar me qëllim të shpërblimit të klientëve besnik duke i ofruar pikë bonusi dhe përfitimet nga zbritjet në produkte të caktuara në rrjetin e Italian Petrol Kosova.

Vërejte: Grumbullimi i pikëve bëhet vetëm për pagesat me para në dorë (cash).

Kushtet e Përgjithshme

Me anë të kushteve të përgjithshme të përdorimit të bonus kartelës së lojalitetit Cartamaxima (tutje: kushtet e përgjithshme), përcaktohen kushtet e përdorimit të kësaj kartele të lëshuar nga kompanija IP-KOS sh.p.k, me adresë në Rr, Elez Berisha nr. 20, 10000 Prishtinë, Kosovë (tutje: lëshuesi i kartelës).

Kushtet e Marrjes së Kartelës

Përfitues i kartelës, mund të jetë çdo person juridik dhe fizik me vendbanim në Republikën e Kosovës, mbi moshën 18 vjeçare, (tutje: mbajtësi i kartelës).

Kartela mund të përfitohet pas plotësimit dhe dorëzimit të formularit të aplikimit (tutje: formulari i aplikimit) në çdo stacion karburanti të kompanisë IP-KOS sh.p.k. Të dhënat e aplikuesit të shënuara në formularin e aplikimit, përdoren ekskluzivisht për lëshim të kartelës si dhe për të informuar mbajtësin e kartelës, ata të cilët kanë zgjedhur opsionin për marketing direkt, për promocionet dhe përfitimet që mund ti kenë nga shfrytëzimi i kartelës.

Me dorëzimin e formularit të aplikimit në cilindo prej stacioneve të karburantit të kompanisë IP-KOS sh.p.k., mbajtësi i kartelës pranon këto kushte të përgjithshme të përdorimit, dhe fiton të drejtën e përdorimit të bonus kartelës pa pagesë. Përdoruesi i kartelës ka të drejtë që në çfardo kohe në formë të shkruar të ndryshoj të dhënat e ofrura në formularin fillestar të aplikimit.

Në rast të keqpërdorimit, kopjimit apo duplikimit të kartelës, e njëjta do të anulohet dhe mbajtësi i saj do të jetë përgjegjës për dëmet e shkaktuara ndaj lëshuesit si rezultat i ndonjë keqpërdorimi eventual.

Limiti kohor i shfytëzimit të pikëve të grumbulluara është 1 vit nga transaksioni i fundit që është përdorur kartela. Në rast se tejkalohet ky limit kohor, atëherë pikët e grumbulluara fshihen nga IP-KOS sh.p.k.

Asistenca ndaj Mbajtësit të Kartelës

Në rast të vjedhjes ose humbjes së kartelës, mbajtësi duhet ta njoftojë menjëherë kompaninë IP-KOS sh.p.k.:

- Duke u paraqitur personalisht në zyrën qendrore me adresë: Rr. Elez Berisha nr. 20, 10000 Prishtinë, Kosovë.
- Tel: 038 755 755
- Tel pa pagesë: 0800 54321
- E-mail adresa: info@ip-kos.com

Për zëvendësim të kartelës së humbur, mbajtësi i kartelës duhet të paguaj koston prej dy (2) euro. Pikët e grumbulluara dhe niveli i përfitimit nga besnikëria mujore dhe vjetore të kartelës së humbur do të transferohen në kartelën e re. Pikët e transferuara nuk mund të shfytëzohen përderisa nuk konfirmohen të gjitha të dhënat me përdoruesin e kartelës. Nëse mbajtësi i kartelës nuk e raporton humbjen, atëher IP-KOS sh.p.k. nuk është përgjegjës për asnjë keqpërdorim të saj.

Çdo person i interesuar lidhur me përfitimin dhe shfrytëzimin e kartelës, mund të marrë informata shtesë në adresën dhe kontaktet e cekura më lartë, në ueb faqen: www.ip-kos.com, si dhe në pikat e karburanteve të IP-KOS sh.p.k.

Mbrojtja e të dhënave

Të gjitha informatat personale të siguruara nga klienti do të trajtohen në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe do të mund të përdoren vetëm pas marrjes së pëlqimit paraprak nga ana e klientit sipas kërkesës dhe kushteve të tij. Pëlqimi për shfrytëzimin e të dhënave personale do ti prezentohet klientit për nënshkrim në kohën e aplikimit për kartelë, së bashku me formularin e aplikimit, dhe i njëjti me vullnet të lirë mund të zgjedhë në dhënien e pëlqimit apo refuzimit për shfrytëzimin e tyre.

Pëlqimi për dhënien e përdorimit të të dhënave personale të klientëve do të ruhet si dokument i veçantë në arkivat e IP-KOS sh.p.k., dhe mund të tërhiqet në çfardo kohe nga klienti.

Ndryshimet e kushteve të përgjithshme

IP-KOS sh.p.k., mund të ndryshoj në çdo kohë kushtet e përgjithshme të përdorimit për arsye të një natyre teknike, tregtare ose për arsye publike.

IP-KOS sh.p.k., duhet të informojë në mënyrën e duhur mbajtësin e kartelës në lidhje me ndonjë ndryshim të kushteve të përgjithshme të përdorimit.

Njoftimi lidhur me ndryshimin e kushteve të përgjithshme të përdorimit të kartelës, dhe implikimit të rregullave të reja së bashku me një shpjegim qartësues IP-KOS sh.p.k. do ta jap në ueb faqen e saj:

www.ip-kos.com. Kushtet e përgjithshme të përdorimit të ndryshuara, hyjnë në fuqi tre ditë pas shpalljes së tyre.

Është e kuptueshme që mbjatesi i kartelës, apriori bie dakor me ndryshimin e kushteve të përgjithshme të përdorimit, nëse ai /ajo nuk e kthen kartelën tek IP-KOS sh.p.k. dhe nuk e dërgon anulimin me shkrim të saj, dhe vazhdon ta përdor atë.

Anulimi i kartelës

Kartela është lëshuar për një periudhë të pacaktuar kohore dhe mbajtësi i kartelës mund ta anuloj atë me shkrim në çdo kohë pa e përmendur ndonjë shkak.

- Anulimi do të hyj në fuqi kur IP-KOS sh.p.k., pranon kërkesën me shkrim për anulim të kartelës në adresën fizike apo elektronike.
- IP-KOS sh.p.k., ruan të drejtën të anuluj në çdo kohë kartelën pa përmendur ndonjë shkak,
- Në rast se IP-KOS sh.p.k anulon kartelën, mbajtësi i kartelës mund ti përdor të gjitha përfitimet e tij/saj, të cilat janë relaizuar gjatë posedimit të kartelës, por jo më larg se dy muaj nga anulimi. Pas kësaj periudhe, këto përfitime do të jenë të pavlefshme dhe nuk do të përdoren më tutje.

Dispozitat tjera

Mbjatësi i kartelës me dorëzimin e formularit të aplikimit konfirmon se ai/ajo ka lexuar dhe kuptuar formularin e aplikimit dhe kushtet e përgjithshme të përdorimit të kartelës, është pajtuar me to dhe përmbajtjen e tyre.

Nga disa produkte si: revista, gazeta ditore, produkte të duhanit apo mbushje telefonike, mund të limitohet mbledhja e pikëve.

Përfitimet nga ky program i kartelës nuk mund të kombinohen me programe/kartela përfituese tjera.

Çdo mosmarreveshje që lind nga përdorimi i kartelës së kompanisë IP-KOS sh.p.k., apo nga kushtet e përgjithshme të përdorimit, për të cilat mbjatesi i kartelës apo lëshuesi nuk mund ti zgjidhin me marrëveshje, kompetente do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë.

Kufizimi i përgjegjësisë

Perveç kufizimeve të përcaktuara në këtë rregullore, IP-KOS sh.p.k. në asnjë rast nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmet direkte, indirekte, te veçanta, rastësishme, pasuese apo kumulative, ose dëmeve të tjera që mund të rezultojnë nga programi ose të ndërlihdura me të, të shkaktuara pjesërisht apo plotësisht nga personeli i IP-KOS sh.p.k. Këto përjashtime dhe kufizime do të zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe do të jenë në fuqi edhe në periudhën pas anulimit ose ndërprerjes së anëtarësisë në program.

Miratimi

Me anë të nënshkrimit tim më poshtë, pranoj se jam pajtuar me kushtet e përgjithshme të programit të Bonus Kartelës së Lojalitetit Cartamaxima.

Nënshkrimi i aplikuesit:

Emri dhe Mbiemri	Data	Nënshkrimi
<hr/>	<hr/>	<hr/>